

Në zbatim të ligjit **nr. 27, datë 17.03.2016**, “ Për menaxhimin e kimikateve”, në [Agjencinë Kombëtare të Mjedisit](#) është krijuar **Spektori i Kimikateve**, si strukturë funksionale në **Drejtorinë e Kërkimit dhe Dijes Mjedisore**.

Detyrat e këtij sektori janë të përshkruara tek Kreu II , neni 6 i këtij ligji, ku pikat **3/f** dhe **3/g** përcaktojnë si detyrë të këtij sektori edhe shërbimi helpdesk dhe dhënien e informacionit, në lidhje me fushën e kimikateve.

Për plotësimin e kësaj detyre është në dispozicion adresa zyrtare e mailit : [info.kimikatet@akm.gov .al](mailto:info.kimikatet@akm.gov.al)

Për çdo informacion të kërkuar ju mund të shkruani tek kjo adresë maili :

✚ nga e hena në të enjte nga ora 8 : 00 – 16 : 30

✚ dhe të premtën nga ora 8 : 00 – 14 : 00

Specialistët e këtij sektori do tju ndihmojnë në zgjidhjen e çështjeve të dërguara nga ju.

### Suport

Ne kryesisht u përgjigjemi pyetjeve në lidhje me përgjegjësitë dhe detyrimet brenda fushës së legjislacionit të kimikateve . Ne nuk mund t'u përgjigjemi pyetjeve në lidhje me përmbajtjen e produkteve individuale ose të vlerësojmë rrezikun e një përdorimi të veçantë të një produkti.

Nëse keni pyetje në lidhje me një produkt specifik ju rekomandojmë të kontaktoni kompaninë ku e keni blerë. Një kompani që vendos një produkt në treg është përgjegjëse për përmbajtjen e produktit dhe mënyrën e përdorimit të tij në mënyrë të sigurt.

### Informacione të nevojshme :

#### Legjislacioni.

*Shumica e legjislacionit ekzistues i është përafëruar legjislacionit të BE-së në fushën e kimikateve.*

Agjencia Kombëtare  
e Mjedisit

*Shembuj janë Rregullorja REACH, Rregullorja CLP, Rregullorja e Produkteve Biocide dhe Rregullorja e Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve.*

✚ Ligji 27.2016 “Menaxhimi i kimikateve”

✚ VKM.665 datë 21.09.2016 “Për eksportin dhe importin e kimikateve”

✚ VKM.665 datë 21.09.2016 “Për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme”

Ju mund të gjeni informacion të nevojshëm dhe në linkun : <https://turizmi.gov.al/kimikate/>



Agjencia Kombëtare  
e Mjedisit

## Pyetje – Pergjigje

### Ku konsiston krijimi i Rregjistrit të Kimikateve ?

Çdo kimikat që prodhohet ose importohet në territorin e Republikës së Shqipërisë regjistrohet në regjistrin elektronik të kimikateve. Ministria krijon dhe mirëmban regjistrin elektronik të kimikateve, në përputhje me standardet, rregullat, dhe procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 10 325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

Prodhuesit, importuesit dhe përdoruesit profesionalë regjistrojnë kimikatet në regjistrin elektronik të kimikateve. Të dhënat mbi produktet e mbrojtjes së bimëve dhe të produkteve biocide sigurohen nga autoritetet përgjegjëse që i regjistrojnë këto kimikate, në përputhje me legjislacionin për produktet e mbrojtjes së bimëve dhe produkteve biocide.

Rregullat e detajuara për regjistrimin e kimikateve nga prodhuesit dhe importuesit, detyrimet për të raportuar në regjistrin elektronik të kimikateve, si dhe mirëmbajtjen e regjistrit të kimikateve, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin.

### Cfarë janë Pesticidet dhe Biocidet ?

Pesticidet përfshijnë produktet kimikë ose biologjikë që synojnë mbrojtjen e bimëve dhe produktet për qëllime veterinare, përgjithësisht kanë si funksion parandalimin e mikroorganizmave si dëmtuesit ose bakteret me anë të veprimit të substancave aktive që përmbahen në produktin biocid, që shkaktojnë dëme në shëndetin e njeriut. Biocidet gjejnë përdorim në shëndetin publik (dezinfektuesit,DDD,etj).

Agjencia Kombëtare  
e Mjedisit

### *A është e nevojshme një procedurë autorizimi për këto produkte ?*

Për shkak të vetive të tyre pesticidet dhe biocidet mund të shkaktojnë dëme gjithashtu dhe në mjedis. Kjo është arsyeja pse pesticidet dhe biocidet duhet të autorizohen për tu importuar dhe duhet të përdoren si duhet. Të gjithë produktet biocid kërkojnë një autorizim para se të vendosen në treg, dhe substancat aktive që përmbahen në atë produkt biocid duhet të aprovohen më parë. Megjithatë, ka disa përjashtime nga ky parim: për shembull, produktet biocid që përmbajnë substanca aktive në Programin e Rishikimit mund të vihen në dispozicion në treg dhe të përdoren (në varësi të ligjeve kombëtare) në pritje të vendimit përfundimtar për miratimin e substancës aktive (dhe deri në 3 vjet ). Produktet që përmbajnë substanca të reja aktive që janë ende nën vlerësim mund të lejohen gjithashtu në treg ku jepet një autorizim i përkohshëm.

### *Cfarë është lista e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë SVHC?*

Substancat, që i përkasin listës SVHC për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, ndalohen të vendosen në treg dhe të përdoren lirshëm në Republikën e Shqipërisë.

Në listën SVHC përfshihen substancat që u korrespondojnë rreziqeve të specifikuara në legjislacionin që rregullon klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve si:

- a) kategoritë kancerogjene 1A dhe 1B
- b) kategoritë mutagjene 1A dhe 1BZ
- c) substancat toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B.

Në listën SVHC përfshihen substancat që plotësojnë kriteret e mëposhtme

- a) substancat që janë të qëndrueshme, të akumulueshme biologjikisht dhe toksike/helmuese (PBT);
- b) substancat që janë shumë të qëndrueshme ose shumë të akumulueshme biologjikisht .

Lista e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC), kriteret për përfshirjen e substancave në listën SVHC dhe lëshimi i një autorizimi të kushtëzuar, me qëllim vazhdimin e përdorimit të SVHC-së miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

Autorizimi i kushtëzuar miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, pa përfshirjen e QKL-së.

Në faqen zyrtare të *Agjencisë Kombëtare të Mjedisit* , <http://www.akm.gov.al/> do të gjeni vazhdimisht informacione të publikuara në lidhje me zbatimin e ligjit për menaxhimin e kimikateve.



Agjencia Kombëtare  
e Mjedisit